

Vendimi Nr. 109/23
Datë: 04.12.2023

Duke u bazuar në nenin 11 par. 3.1, nenet 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 par 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 04.12.2023, mori këtë;

V E N D I M

I. LEJOHET. Përqendrimi i ndërmarrjeve Gjirafa Inc dhe Carvago Holding a.s., lidhur me krijimin e një ndërmarrje të përbashkët JV (joint venture) me funksion të plotë Carvago by Gjirafa.

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 1000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me nenin 18 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja gjashtë mijë Euro.

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 20.10.2023, me Nr. Prot. 490/23-11/H ka pranuar kërkesën për Përqendrim lidhur me krijimin e një ndërmarrje të përbashkët (joint venture) Carvago by Gjirafa nga Gjirafa Inc dhe Carvago Holding a.s.

Procedurat e ndjekura:

1. Vlerësimi i Lëndës
2. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 10.11.2023
3. Njoftimi për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 14.11.2023
4. Më datë 19 shtator 2023, palët kanë lidhur Marrëveshjen për krijimin e Ndërmarrjes së Përbashkët (Joint venture) me të cilin të dy kompanit Gjirafa Inc dhe Carvago Holding a.s., do të ushtrij kontroll të përbashkët mbi JV Carvago by Gjirafa.

Gjirafa Inc, është korporatë e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Shtetit të Delaware, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me numër të biznesit ID No.: 46-5435481

dhe adresë të regjistruar në regjistruar në: c/o. Incorp Services Inc., 919 North Market Street, Suite 950, Wilmington, DE, County of New Castle, 19801, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Aktivitete e biznesit: platformë për tregtinë elektronike (e-commerce) platformë marketingu online, platformë për përmbajtje video/lajme dhe motor kërkimi në gjuhën shqipe.

Gjirafa ka një degë të shoqërisë së huaj të regjistruar në Kosovë, Gjirafa Inc Dega në Kosovë, me numër unik të identifikimit 8108403076 Gjirafa, Inc Dega në Kosovë, operon në Kosovë si një platformë e-commerce duke operuar përmes Gjirafa 50, 1P e-commerce dhe Gjirafa Mall, një platformë e tregtis elektronike 3P, në anën mediatike dhe botuese operon me rrjetin më të madh të reklamave online përmes Gjirafa Ads, dhe platformës së transmetimit të videove përmes Gjirafa Video, dhe biznesit transaksional Gjirafa Travel.

Gjirafa Inc ka edhe një filiale në pronësi të plotë në Kosovë. Gjirafa Kosovë L.L.C., me numër unik identifikimi 810123860, e cila është pronare e vetme e Trekandi Sh.p.k., me numër unik identifikimi 810046757.

Carvago Holding a.s. është një shoqëri aksionare e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Republikës Çeke, me numër të regjistrimit të biznesit 080234144 dhe adresë të regjistruar në: Platněřská 88/9, Staré Město 110 00 Prage, 1 Republika Çeke. Aktivitetet e biznesit: blerja dhe shitja e makinave të përdorura nëpërmjet një platforme online dhe të ofrimit të shërbimeve plotësuese përkatëse.

Baza juridike:

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

- a. Qarkullimi i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000 Euro.
- b. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro.
- c. Parashtruesit e kërkesës kanë për qëllim të ekzekutojnë Marrëveshjen lidhur me krijimin e një ndërmarrje të përbashkët (joint venture) me funksion të plotë të lidhur me 19 shtator 2023.
- d. Kërkesa për përqendrim është bërë për arsye se njëri ka Aplikuesi ka filiale të regjistruar në Republikën e Kosovës.

Analiza e konkurrencës:

Transaksioni i propozuar ka të bëjë me krijimin e një ndërmarrje të përbashkët JV (joint venture) Carvago by Gjirafa nga Gjirafa Inc dhe Carvago Holding a.s., me të cilën të dy palët do të ushtrojnë kontroll të përbashkët mbi ndërmarrjen e krijuar JV. Gjegjësisht, Gjirafa Inc dhe Carvago Holding a.s., do të themelojnë një ndërmarrje të përbashkët në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me ligjet e Republikës së Kosovës me 50% të aksioneve në pronësi të secilit aksionar. Parashikohet që JV do të jetë

krijoi një shërbim në treg, duke krijuar një platformë online për blerjen dhe shitjen e veturave të përdorura në Republikën e Kosovës.

Sipas vlerësimit të tregut përkatës, Tregu i makinave të përdorura në Kosovë në vitin 2022 arriti në një vlerë prej rreth 300 milionë euro. Bazuar në analizën e konkurrenteve, gamen e shërbimeve në treg dhe modelin e biznesit që do të prezantoj Carvago by Gjirafa, parashikohet që Carvago by Gjirafa gjatë vitit të parë të operimit të arrijë një nivel vjetor shitjesh prej 1.7 milionë euro. Duke qenë se tregu i shitjes së makinave të përdorura ka arritur vlerën prej 300 milion euro në vitin 2022, dhe Carvago by Gjirafa pritet të arrijë një nivel shitjeje prej 1,7 milion euro. Pjesa e tregut e Carvago by Gjirafa në shitjen e makinave të përdorura do të jetë me pak se 1%. Prandaj, ky transaksion nuk do të shkaktojë shtrembërim të konkurrencës apo krijim të pozitës dominuese në tregun e Kosovës, për arsye se tregu i shitjes së makinave në Kosovë është treg shumë konkurrues duke pas parasysh numrin e madh të bizneseve të cilat merren me shitjen e veturave në Kosovë.

Tregjet Relevante dhe Vlerësimi i Konkurrencës

Tregu relevant, tregut relevant mbetet i pandryshuar edhe pas transaksionit.

Tregu i produktit, JV do të krijojë një shërbim të ri në treg. Përkatësisht biznesi i JV-së do të konsistojë në blerjen dhe shitjen e veturave të përdorura dhe shërbimeve përkatëse përmes një platformë online në Republikën e Kosovës.

Në këtë drejtim, blerja dhe shitja e makinave të përdorura dhe shërbimeve të lidhura me to konsiderohen si treg përkatës i produktit.

Tregu gjeografik, në transaksionin e propozuar do të jetë territori i Republikës së Kosovës.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës, nga transaksioni i realizuar

Transaksioni i propozuar do të realizohet në tregun gjeografik të Republikës së Kosovës. Kërkesa për Njoftim të Përqendrimit është bërë për arsye se njëra nga palët ka degë të regjistruar në Republikën e Kosovës dhe Ndërmarrja e Përbashkët do të operojë në tregun e Kosovës. Carvago by Girafa do t'u ofrojë konsumatorëve kosovar blerjen dhe shitjen e veturave të përdorura tërësisht online. Platforma do të veprojë si një treg makinash në internet dhe do të bëjë të disponueshme blerjen e makinave nga e gjithë Evropa për klientët individual dhe të biznesit. Përkatësisht, Carvago është treg online që ka kontrata me sallonet e makinave dhe tregtarët e makinave në Evropë për shitjen e makinave të tyre. Në këtë drejtim, Carvago by Gjirafa nuk do të ketë një stok makinash, por do t'u ofrojë klientëve të zgjedhin makinat online dhe kur klienti të vendos për një makinë kjo kompani do ta blejë makinën nga koncesionari përkatës dhe do ta sjellë tek klienti në Kosovë. Modeli i biznesit që do të prezantojë JV, pra blerja e automjeteve të përdorura tërësisht online, aktualisht nuk është në dispozicion në Kosovë, mirëpo sa i përket tregut për shitjen e makinave është treg mjaftë konkurrues. Prandaj, ky transaksion nuk do të

shkaktojë shtrembërim të konkurrencës apo krijim të pozitës dominuese në tregun e Kosovës, për sa i përket tregu të shitjes së makinave.

Komisioni i Konkurrencës ka vlerësuar se transaksioni nuk paraqet efekte negative, në konkurrencë për arsye se ky transaksion /blerja nuk ndikon në forcimin e pozitës dominuese të ndërmarrjes blerëse, tek operatorët ekonomik apo konsumatorët.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti - konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

AUTORITETI I KONKURRENCËS

Neime Binaku-Isufi
Kryetare




Kaltrina Sela
Zv. Kryetare



Nafije Osdautaj
Anëtare



Florent Mehmeti
Anëtar



Salihe Gashi-Loku
Anëtare



III. Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva